



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	05 - 12 2022	viti qid year	
Organi / Agjencia Organi / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot Dr. Prot Prot No	Shtesa e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	7672	/2022	115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.938/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.938/2022 të datës 21.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga kundër Vendimit me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.938/2022 e datës 21.10.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër DBNJ Nr. 151/2022 i datës 11.10.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### A r s y e t i m

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 30.08.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr. Reference:RN00009757 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Auditor i Brendshëm", ku afati për aplikim rrjedh nga data 14.09.2022-21.09.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesja, ndërsa në bazë të Vendimit me numër DBNJ Nr.144/2022 të datës 28.09.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos plotësimit të kushteve sepse i mungon certifikata e

auditimit të brendshëm. Ankuesja kundër këtij vendimi më datë 06.10.2022 ka parashtruar ankesë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa ky i fundit për Vendimit me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022, ka refuzuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 21.10.2022, ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:6363/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.10.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Më datë 02.11.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:6363/2022 të datës 21.10.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ankesën me Nr. Prot:4589/2022 të datës 06.10.2022 nga ankuesja për Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Vendimi me numër DBNJ Nr. 144/2022 të datës 28.09.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Konkursin Nr. Reference:RN00009757 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Auditor i Brendshëm"; Informata mbi Studentin M.B me nr.regj.7410 të datës 09.08.2022; Verifikim Paraprak për pozitën Auditor i Brendshëm me nr.prot:4436/2022 të datës 29.09.2022; Rezultatet e Verifikimit Paraprak të datës 29.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.10.2022; Përgjigjeje në kërkesë të datës 02.11.2022; Lista e Aplikantëve (kandidatëve në pritje) nga SIMBNJ; Lista e kandidatëve të aprovuar si dhe të kandidatëve të refuzuar; Emalin e datës 29.09.2022 për njoftim për ankesën për mos plotësim të kriterëve të konkursit; Aplikacioni i ankueses i datës 21.09.2022; Diplomë me titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatikë; Certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin për procedurat e dhënies së garantëve; Certifikatë për Akreditim Zhvillimor; Ligjëratat të Ndjekura nga Europass; Certificate for Public Policy Development and Leadership (PPDL); Certifikatë për bazat e kompjuterit; Certifikatë AFAS; Marrëveshje për Shërbim të Veçanta në MKRS; Akt Emërimi për me titullin : Zyrtare e Pasurisë me datë 07.03.2016; Letër Konfirmimi e datës 15.Gusht.2022; Letërnjoftimi; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil 2022; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë 2021; Vërtetim i datës 21.09.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, **SEPSE:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit, pretendon që ky vendim është nxjerr me referim të gabuar të bazës ligjore pasi që i njëjti në preambulën e tij referohet nenit 45 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, dispozite e cila i referohet Verifikimit paraprak; Në konkursin e shpallur nuk ka pikë ku kërkohet që të dorëzohet certifikata e auditimit të brendshëm.

Në bazë të konkursit me Nr. Reference:RN00009757 të datës 30.08.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën " Auditor i Brendshëm" të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kërkesë e përgjithshme formale janë kërkuar: "Arsini i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, fakulteti: juridik ose ekonomik me të paktën 240 kredi apo ekuivalente me to. Përvoja e punës e kërkuar: "Së paku tri vite përvojë pune profesionale", ndërsa tek kualifikimet e posaçme formale është kërkuar: "Certifikatë, Licenca ku kërkohet me legjislacionin në fuqi apo ku apo ku vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me këtë çështje juridike administrative, i'u referua Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, gjegjësisht nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.16, i cili përcakton se: "Auditori i brendshëm - nënkupton personin fizik ose juridik të caktuar për ofrimin e vlerësimeve të pavarura dhe objektive për veprimtaritë financiare dhe operative të subjektit publik, i certifikuar sipas nenit 22 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2, ndërsa neni 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i këtij ligji, përcakton se: "2. Auditorët e njësisë së auditimit të brendshëm duhet të kenë kualifikimet si në vijim: 2.2. certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave".

Duke marr parasysh kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe duke marr parasysh kualifikimet e posaçme formale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën " Auditor i Brendshëm" të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk ka dorëzuar Certifikatë të auditorit të brendshëm, rrjedhimisht ankuesja nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara në konkurs të përcaktuar në pikën 5 të tij, kështu që pretendimi i ankueses se në konkursin e shpallur nuk ka pikë ku kërkohet që të dorëzohet certifikata e auditimit të brendshëm është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në kriteret e konkursit, dëshmitë e dorëzuara nga ankuesja me rasatin e aplikimit si dhe kushteve ligjore të kërkuar për këtë pozitë, konstaton se ankuesja nuk ka plotësuar kushtet për të vazhduar në fazat e tjera të procedurës, respektivisht nuk ka plotësuar kushtin e kualifikimeve të posaçme formale, rrjedhimisht Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër DBJN Nr.144/2022 të datës 28.09.2022 ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: *“1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin”.*

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses e cila pretendon se Vendimi me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i referohet nenit 45 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, dispozite e cila i referohet Verifikimit paraprak, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se neni 45 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, përveç verifikimit paraprak i referohet rasteve të shqyrtimit të ankesës nga Njësia e Burimeve Njerëzore siç parashihet me paragrafin 6 të nenit 45 të kësaj rregulloreje, i cili përcakton se: *“6...Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”*, kështu që pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër DBNJ Nr. 151/2022 të datës 11.10.2022 dhe Vendimi me numër DBNJ Nr. 151/2022 i datës 11.10.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me refuzimin e aplikacionit e ankueses respektivisht refuzimin e ankesës, janë nxjerr në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/LI-114 PËR Zyrtarët Publikë, dhe nenin 41, 44 dhe 45 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.938/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.